

VENDIM
Nr. 608, datë 22.9.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.360, DATË 26.4.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
ARKIVAVE’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15, pika 2, e 94, të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun I, të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, bashkëlidhur vendimit nr.360, datë 26.4.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a) Në nenin 4, shkronjat “l”, “ll” dhe “m” shfuqizohen.
- b) Pas nenit 4 shtohet neni 4/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1
Blerja e përqendruar

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen blerjen e përqendruar për të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për furnizimin me kuti dhe dosje të standardit të përhershëm, përfshirë edhe etiketat e tyre. Procedura e prokurimit kryhet çdo vit për vitin pasardhës, duke marrë parasysh në këtë procedurë edhe shtrirjen gjeografike të vendruajtjes depozituese finale të dokumentacionit arkivor, për të cilin kryhet blerja e përqendruar.

2. Brenda datës 1 shkurt të çdo viti, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave njofton përmes rrugës shkresore dhe/ose elektronike autoritetet dhe entet kontraktore për:

- a) standardet kombëtare të miratuara për kutitë dhe dosjet e standardit të përhershëm;
- b) çmimin për njësi të llogaritur përmes parashikimeve ligjore, e indeksuar me ndryshimet e mundshme të evidentuara gjatë studimit paraprak të tregut, të kryer prej saj.

3. Brenda datës 1 mars, autoritetet ose entet kontraktore i dërgojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave specifikimet teknike, kërkesat sasiore dhe fondin limit. Kërkesat e dërguara pas kësaj date nuk merren parasysh për prokurimin për vitin pasardhës.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen procedurën e prokurimit nga procesi i njoftimit të kontratës deri në nënshkrimin e marrëveshjes kuadër, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

5. Për çdo kontratë të lidhur nga autoritetet dhe entet kontraktore, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave kryen verifikimin paraprak të cilësisë për sa i përket jetëgjatësisë së kutive dhe dosjeve të standardit të përhershëm, sipas udhëzimeve administrative të saj. Autoritetet ose entet kontraktore marrin në dorëzim kutitë dhe dosjet bashkë me dokumentacionin shoqërues të verifikimit paraprak të cilësisë.”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku